



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 8/2024

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 86/2018
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE
TË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe nenit 37 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 86, datë 19.7.2018, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 25.1.2024